



BASHKIA E KORÇË  
NR 2335 PROT  
DATA 20/03/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

Nr. 570 protokolli

Korçë, më 19 / 03 / 2024

LËNDA: KËRKESË PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

DREJTUAR: KRYETARIT TË BASHKISË KORÇË  
Z. SOTIRAQ FILO

KRYETARES SË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË  
Z.NJ.ANA VERUSHI

KËSHILLTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

I NDERUAR KRYETAR,

TË NDERUAR KËSHILLTARË,

Universiteti "Fan S. Noli" në Korrik të këtij viti do të marrë pjesë në Lojrat Europiane Universitare duke u përfaqësuar me ekipin e futbollit.

Lojrat Europiane Universitare zhvillohen çdo dy vjet dhe këtë vit do të zhvillohen në qytetet Debrecen dhe Miskolc të Hungarisë.

Në këto lojra sportive universitare marrim pjesë rreth 6000 studente nga 450 universitete të Europës.

**Theksojmë se Universiteti "Fan S. Noli" është i vetmi universitet në Shqipëri që është anëtar me të drejta të plota i Federatës Europiane të Sportit Universitar (EUSA).**

Përsa më sipër , pjesëmarrja në këtë eveniment ndërkombëtar ka dhe një kosto të caktuar për të cilën ne si institucion apo dhe nga vetë studentët pjesëmarrës dhe stafi është e pa përballueshme.

**Po Ju drejtohem me anë të kësaj kërkesë për mbështetje financiare nga ana e Bashkisë Korçë, për të bërë të mundur pjesëmarrjen sa më dinjitoze të ekipit që përfaqëson universitetin tonë, por edhe qytetin tonë Korçën.**

Më poshtë po ju bëjmë dhe një pasqyrë të kostove;

Ekipi i futbollit të universitetit "Fan S. Noli" përbëhet nga 20 veta (18 lojtarë + 2 staf), të cilët janë kryesisht studente të programit të studimit "Edukim Fizik dhe Sporte".

Për çdo person (lojtar apo staf) EUSA ka një tarifë prej 75 euro në ditë qëndrimi.

Ditët e qëndrimit në kompeticion janë 9, pra për çdo person janë  $9 \times 75 = 675$  euro. Përveç këtyre, EUSA ka një taksë 50 euro për person për pjesëmarrje, kështu që për një person fatura shkon në 715 euro. Ekipi i futbollit përbëhet nga 20 veta, pra, fatura totale shkon në **14,300 euro** (përveç transportit).

**Mbështetja nga bashkia kërkohet në vlerën 7000 euro.**

Pjesa tjetër e shpenzimeve është me mbështetje nga universiteti (3000 euro), dhe kontribute personale të secilit pjesëmarrësi.

**Duke Ju falenderuar,**

**Mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive !**

**Zv. Rektori për mësimin dhe sportin**

**Dr. Arto Adili**

